

VENDIM
Nr. 476, datë 30.5.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 207, DATË 9.3.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË
POLIÇAN, TË QARKUT TË BERATIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit, miratuar me vendimin nr. 207, datë 9.3.2011 të Këshillit të Ministrave, të shtohen pronat me nr. 89-293 (tetëdhjetë e nëntë-dyqind e nëntëdhjetë e tre), gjithsej 29 (njëzet e nëntë) fletë, sipas lidhjes nr. 1 dhe formularëve, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Poliçan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha